



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 03 / L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77 / 16 gusht 2010), nenit 1, nenit 44 paragrafi 1, nën paragrafët 1.4 dhe 1.18 dhe nenit 85 të Ligjit nr. 04 / L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11 / 11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 31 gusht 2016, miratoi si vijon:

## **RREGULLORE PËR LETËRKREDINË DHE GARANCIONIN BANKAR**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është që të definojë rregullat dhe procedurat për lëshimin e letërkredisë dhe garancionit bankar.
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjitha bankat e licencuara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës.
3. Nxjerrja e kësaj rregulloreje është në përputhje me nenin 1058 paragrafi 3 të Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve dhe ligjet e tjera të aplikueshme në kohën e nxjerrjes së saj.

### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

1. Të gjithë termat e përdorur në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë me termat e përkufizuar në nenin 3 të Ligjit Nr.04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare (në vijim: Ligji për bankat) dhe / ose me përkufizimet në vijim për qëllimin e kësaj rregulloreje:

**1.1. Letërkredi** –nënkupton çdo marrëveshje, pavarësisht emërimit apo përshkrimit, që është e pakthyeshme dhe në këtë mënyrë përbën një obligim të përcaktuar të bankës lëshuese për të kryer pagesën me kusht, që dokumentet e kërkuara me letërkredi të prezantohen në përputhje me termat dhe kushtet e letërkredisë, dispozitat e aplikueshme të rregullave dhe praktikave uniforme të ICC-së për kreditë dokumentare (UCP 600);

- 1.2. Garancion Bankar me Kërkesë ose Garancion Bankar** – nënkupton çdo dokument të nënshkruar, në formë fizike apo në mënyrë elektronike, sido që të quhet apo përshkruhet, i cili krijon obligim për garantuesin që të kryejë pagesën përkundrejt prezantimit të dokumenteve të kërkuara me garancion, për sa kohë ato janë në përputhje me afatet dhe kushtet e garancionit dhe me rregullat uniforme për garancionet sipas kërkesës - URDG 758 të referuara në nenin 14 të kësaj rregulloreje;
- 1.3. Banka Lëshuese/Garantuese** – nënkupton bankën e cila lëshon letër-kreditin apo garancionin me kërkesë të aplikuesit apo në emër të tij;
- 1.4. Banka Konfirmuese** – nënkupton bankën e cila shton konfirmimin e saj në letërkreditin apo garancionin me kërkesën apo autorizimin e bankës lëshuese;
- 1.5. Aplikuesi** – nënkupton palën me kërkesë të së cilës lëshohet letërkredia apo garancioni;
- 1.6. Përfitues** – nënkupton palën në favor të së cilës është lëshuar letërkredia apo garancioni;
- 1.7. Prezantimi** – nënkupton dorëzimin e dokumenteve në bazë të letër-kreditit të banka lëshuese ose banka nominuese;
- 1.8. Prezantues** – nënkupton përfituesin, bankën ose palën tjetër që e bën prezantimin e dokumenteve;
- 1.9. Banka Nominuese** – nënkupton bankën përmes së cilës realizohet pagesa në bazë të letërkreditit apo çfarëdo banke në rast se letërkredia është e vlefshme/realizueshme në cilëndo bankë;
- 1.10. Banka Transferuese** – nënkupton bankën nominuese që transferon letërkreditin, ose në rastet kur letërkredia është e vlefshme/realizueshme me cilëndo bankë, pra nënkupton bankën e cila është e autorizuar në mënyrë specifike nga banka lëshuese për ta transferuar letërkreditin dhe që e transferon atë. Banka lëshuese mund të jetë edhe bankë transferuese;
- 1.11. Kundërgarancioni** – nënkupton çdo obligim të nënshkruar, pavarësisht se si quhet apo përshkruhet, i cili jepet nga kundërgarantuesi i një pale tjetër për të siguruar lëshimin nga ajo palë të një garancioni apo të një kundërgarancioni tjetër, që mundëson pagesën përkundrejt prezantimit të një kërkesë të rregullt sipas kundërgarancionit të lëshuar në favor të asaj pale.

### **Neni 3**

#### **Letër kredia**

1. Banka lëshuese, me rastin e lëshimit të letërkreditit me kërkesë të aplikuesit, obligohet që përfituesit të letërkreditit t'i paguajë shumën e caktuar të të hollave të përcaktuar në letërkredit, në datën e caktuar për pagesë, në qoftë se përmbushen kushtet e përcaktuara me rastin e lëshimit të letërkreditit.
2. Letërkredia duhet të jetë në formë të shkruar dhe të nënshkruhet me dorëshkrim apo/dhe në nënshkrim elektronik të autentifikuar.

3. Për qëllim të paragrafit 2 të këtij neni, autentifikimi është procesi përmes të cilit pala të cilës i është prezentuar dokumenti është në gjendje për të verifikuar identitetin e paraqitur të dërguesit dhe nëse të dhënat e pranuar kanë mbetur të plota dhe të pandryshuara.
4. Letërkredia përveç tjerash duhet të përmbajë: obligimin për pagesë të përcaktuar nga banka lëshuese, të dhënat për aplikuesin dhe përfituesin, dokumentet që duhen paraqitur dhe afatet për paraqitjen e dokumenteve të kërkuara.

#### **Neni 4**

#### **Obligimi i bankës dhe i aplikuesit**

1. Banka merr obligim të paktheyshtëm ndaj përfituesit që nga momenti i lëshimit të letërkredisë.
2. Aplikuesi merr obligim të paktheyshtëm ndaj bankës lëshuese që nga momenti i nënshkrimit të aplikacionit për lëshim të letërkredisë dhe dokumenteve të tjera të kërkuara nga banka.

#### **Neni 5**

#### **Pavarësia e letër kredisë**

1. Letërkredia është tërësisht e pavarur dhe e ndarë nga kontrata e shitjes në bazë të së cilës lëshohet letërkredia, sikurse edhe nga transaksionet e tjera.
2. Banka lëshuese ekzekuton pagesën bazuar në prezantimin e dokumenteve sipas afateve dhe kushteve specifike të letërkredisë, pa marrë parasysh performancën e kontratës në fjalë apo ndonjë transaksioni tjetër.

#### **Neni 6**

#### **Letër kredia dokumentare**

1. Letërkredia dokumentare është zotim i bankës që t'i paguajë përfituesit të letërkredisë shumën e caktuar të mjeteve, me kusht që në afatin e caktuar t'i paraqiten dokumentet sipas kushteve specifike të përcaktuara me letërkredinë.
2. Letërkredia është e paktheyshme edhe nëse nuk është specifikuar si e tillë në kontratë.
3. Letërkredia dokumentare përmban detyrimin e pavarur dhe direkt të bankës ndaj përfituesit.
4. Me kërkesë të bankës lëshuese, letërkredia dokumentare mund të konfirmohet nga ana e ndonjë banke tjetër (banka konfirmuese, një bankë tjetër nga banka lëshuese), e cila merr përsipër detyrimin e pavarur dhe direkt ndaj përfituesit.

5. Njoftimi i letërkredisë përfituesit nga ana e ndonjë banke tjetër (bankës njoftuese), nuk përbën vetvetiu konfirmimin e letërkredisë.

## **Neni 7**

### **Obligimet dhe përgjegjësitë e bankës për letërkreditinë dokumentare**

1. Banka që e hap letërkreditinë dokumentare ka për detyrë të kryejë pagesat, sipas kushteve të përcaktuara me letërkreditinë dokumentuare.
2. Banka ka për detyrë të shqyrtojë nëse dokumentet janë në përputhje me kushtet e përcaktuara në letërkredi, sipas kërkesës së aplikuesit.
3. Banka nominuese që vepron në bazë të nominimit të saj, banka konfirmuese, nëse ka, si dhe banka lëshuese, secila prej tyre duhet që brenda 5 (pesë) ditë pune, duke filluar nga dita e punës që pason ditën e paraqitjes së kërkesës, të përcaktojnë nëse kërkesa është bërë në pajtim me kushtet e letërkredisë.
4. Nëse njëra nga bankat e përmendur në paragrafin 3 të këtij neni, konstaton parregullsinë e dokumenteve dhe vendos të refuzojë kryerjen e pagesës apo negocimin, ajo duhet që brenda afatit prej 5 (pesë) ditë pune, duke filluar nga dita e punës që pason ditën e konstatimit të parregullsisë së dokumenteve të japë te prezantuesi një njoftim lidhur me refuzimin duke specifikuar secilën parregullsi për të cilën banka refuzon të kryejë pagesën apo të negociojë.
5. Banka nuk merr mbi vete asnjë përgjegjësi nëse dokumentet ashtu siç janë paraqitur janë në përputhje me kushtet e letërkredisë.
6. Banka nuk merr mbi vete asnjë detyrim sa i përket mallit, shërbimeve apo performancës, me të cilat mund të ndërlidhen dokumentet.

## **Neni 8**

### **Transferimi i letër kredisë dokumentare**

1. Letërkredia dokumentare e transferueshme nënkupton letërkreditinë e cila përcakton specifikisht se është “e transferueshme”.
2. Një letërkredi e transferueshme mund të vihet në dispozicion tërësisht ose pjesërisht për një përfitues tjetër (“përfituesit të dytë”) me kërkesë të përfituesit (“përfituesit të parë”).
3. Letërkredia mund të transferohet pjesërisht te më shumë se një përfitues, me kusht që të jenë të lejuara dërgesat apo ngarkesat e pjesërishtme .
4. Letërkredia e transferuar nuk mund të transferohet me kërkesë të përfituesit të dytë te ndonjë përfitues pasues. Përfituesi i parë nuk konsiderohet të jetë përfitues pasues.

## **Neni 9**

### **Garancioni bankar**

1. Përmes garancionit bankar, banka merr obligim të pakthyesëm për kryerje të pagesës ndaj përfituesit, por duke mos tejkaluar shumën e garancionit, me kusht që kërkesa e prezentuar për pagesë të jetë në pajtim të plotë me kushtet e garancionit.
2. Garancioni bankar duhet të lëshohet në formë të shkruar apo edhe në mënyrë elektronike përmes SWIFT-it.
3. Nëse një bankë tjetër ka konfirmuar përgjegjësinë që rrjedhë nga garancioni përfituesi mund të parashtojë kërkesën sipas garancionit ose ndaj bankës lëshuese ose bankës konfirmuese të garancionit.

## **Neni 10**

### **Obligimet dhe përgjegjësitë e bankës për garancionin**

Banka paguan detyrimin nga garancioni në para të gatshme edhe në rastin kur me garancion sigurohet detyrimi jomonetar.

## **Neni 11**

### **Kundër-Garancioni**

Në qoftë se me kërkesë të një banke tjetër ("kundërgarantuesi"), banka ("garantuesi") e lëshon garancionin në favor të përfituesit, atëherë përfituesi duhet që kërkesën e vet t'ia paraqes bankës e cila ka lëshuar garancionin.

## **Neni 12**

### **Transferimi i Garancionit**

1. Garancioni i transferueshëm nënkupton një garancion që mund të bëhet i vlefshëm nga garantuesi për një përfitues të ri (përfituesi i transferimit) me kërkesë të përfituesit ekzistues ("kërkuesi i transferimit"). Edhe nëse një garancion përcakton specifikisht që është i transferueshëm, garantuesi nuk është i detyruar të zbatojë kërkesën për transferimin e garancionit pas lëshimit të tij, përveç rasteve kur garantuesi ka rënë dakord shprehimisht për kryerjen e transferimit.
2. Një garancion mund të transferohet vetëm kur kërkuesi i transferimit t'i ketë paraqitur garantuesit një deklaratë të nënshkruar, ku shprehet se përfituesi i transferimit ka fituar të drejtat dhe detyrimet e kërkuesit të transferimit në marrëveshjen bazë. Pavarësisht nëse garancioni shpreh apo jo që është i transferueshëm, dhe në përputhje me dispozitat e ligjeve të zbatueshme, përfituesi mund t'i kalojë një pale tjetër çdo të drejtë mbi të ardhurat që zotëron ose mund të zotërojë në të ardhmen sipas garancionit.

**Neni 13**  
**Garancioni bankar me kërkesë**

1. Në qoftë se garancioni bankar përmban klauzolën “me kërkesë”, ose përmban fjalë që kanë domethënie të njëjtë, banka nuk mund të paraqes ndaj përfituesit kundërshtime që aplikuesi, si debitor mund t'i paraqesë ndaj përfituesit sipas detyrimit të siguruar.
2. Aplikuesi ka për detyrë t'i paguajë bankës çdo shumë që e ka paguar banka në bazë të garancionit bankar të lëshuar me klauzolën nga paragrafi 1 i këtij neni.
3. Përfituesi i garancionit bankar e debiton nga aplikuesi shumën e pranuar sipas këtij garancioni, gjë të cilën nuk do të kishte të drejtë ta bëjë për shkak të kundërshtimeve të arsyeshme të aplikuesit.

**Neni 14**  
**Dispozitat përfundimtare**

Për çfarëdo që nuk është përcaktuar me këtë rregullore për letërkredinë dhe garancionin bankar, do të zbatohen *mutatis mutandis* rregullat standarde të Odës Ndërkombëtare të Tregtisë (Zakonet dhe Praktikrat Uniforme për Kreditë Dokumentare - UCP 600 dhe Rregullat Uniforme për Garancionet sipas Kërkesës - URDG 758).

**Neni 15**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi më 15 shtator 2016.

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

---

Prof. Dr. Bedri Peci